



01Nr. 104/02-14399/23
Kaçanik, 30.06.2023

Në mbështetje të nenit 12, 14 lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 3041-2/23 i datës 12.06.2023, për Rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit- Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-11896/23 -për caktimin e lokacionit për nevoja të HANIDKOS, të datës 30.05.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 qershor 2023, mori këtë:

VENDIM

PËR KONSTATIM TË VENDIMIT 01NR. 104/02-11896/23 I DATËS 30.05.2023 SE ËSHTË NË HARMONI ME DOKUMENTET SI NË KËRKESËN E MMPHI NR.3041-2/23 TË DATËS 12.06.2023 PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMERISË SË AKTIT

1. Me këtë Vendim, konstatohet se Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-11896/23 për caktimin e lokacionit për nevoja të HANIDKOS i datës 30.05.2023, është harmoni me dokumentacionin e nevojshëm të theksuara në arsyetim të shkresës së MMPHI 3041-2/23 i datës 12.06.2023 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit.
2. Në dokumentet e planifikimit janë përcaktuar shfrytëzimet dhe nëse këto shfrytëzime janë konform kërkesës, atëherë Kuvendi i Komunës nuk ka nevojë të nxjerrë vendim tjetër. Kjo është theksuar në pikën e fundit të kërkesës së MMPHI.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është shkresa e DUKMM që arsyeton faktet se Vendimi i Kuvendit të Komunës si në pikën 1. të këtij vendimi është në harmoni me kërkesat e MMPHI të theksuara në arsyetim të shkresës për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet HANDIKOS dhe mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli





01Nr. 104/02-14399/23
Kaçanik, 30.06.2023

U prilog članu 12, 14 u vezi sa članom 17 Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi Republike Kosovo (Službeni list Republike Kosovo br. 28 od 4. juna 2008), Zahtev Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture 3041-2/23 od 12.06.2023.godine za preispitivanje zakonitosti akta-Odluke SO 01 br. 104/02-11896/23 - za dodelu lokacije za potrebe HANIDKOS, dana 30.05.2023, Skupština opštine Kaçanik je na sednici održanoj 30. juna 2023. godine primila:

O D L U K A
ZA POTVRĐIVANJE ODLUKE 01 BR. 104/02-11896/23 OD 30.05.2023 DA JE U
SKLADU SA DOKUMENTIMA KAO U ZAHTEVU MMPHI BR.3041-2/23 OD
12.06.2023 ZA REVIZIJU LEG

1. Ovom Odlukom se utvrđuje da je Odlukom Skupštine opštine 01 br. 104/02-11896/23 za dodjelu lokacije za potrebe HANIDKOS-a od 30.05.2023. godine, u skladu je sa potrebnom dokumentacijom istaknutom u obrazloženju dopisa MMPHI-a 3041-2/23 od 12.06.2023. - ispitivanje zakonitosti akta.
2. Namene su definisane planskim dokumentima i ako su ove namene u skladu sa zahtevom, onda Skupština opštine ne treba da donosi drugu odluku. Ovo je istaknuto u poslednjoj tački zahteva MMPHI.
3. Sastavni deo ove odluke je i dopis DUKMM kojim se obrazlažu činjenice da je Odluka Skupštine opštine iz tačke 1. ove odluke u skladu sa zahtevima MMPHI istaknutim u obrazloženju pisma za re. -ispitivanje zakonitosti akta.
4. O sprovođenju ove odluke staraće se: Predsednik Opštine, Odjeljenje za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine.
5. Ova odluka stupa na snagu 15 dana od dana registracije u kancelariji protokola nadzornog organa MALS-a, kao i nakon objavljivanja na zvaničnom sajtu opštine.

Ovom Odlukom obavještavaju se: Predsednik Opštine; Direkcija za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine (handikos i drugi relevantni mehanizmi se obaveštavaju preko ove direkcije); Arhiva.

Predsedavajući Skupštine
Koral Murseli





01Nr. 104/02-11896/23
Kačanik, 30.05.2023

Në mbështetje të nenit 58, pika (h), nenit 17, pika (c), dhe (s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6, pika (b), (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetari i Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhje të mbajtur me 30 maj 2023, merr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TË NDRYSHME PËR NEVOJAT E ORGANIZATËS HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e organizatës HANDIKOS.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1. të këtij vendimi, do të jetë në pjesët e parcelave kadastrale sipas certifikatës së pronësisë, Nr. P-70917008-00228-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11322.8m², dhe Nr. P-70917008-00229-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2965.3 m², Zona Kadastrale Kačanik, të evidentuar në pronësi Komuna e Kaçanikut.
3. Nga sipërfaqja përgjithshme parcelave të cekur në nenin 2 të këtij Vendimi, ndahen nga parcela Nr. P-70917008-00228-0, në 241m² (dyqind e katër dhjetë e një metër katror), dhe nga parcela P-70917008-00229-0, në 303m² (treqind e tri metër katror), me sipërfaqe të përgjithshme për caktim të lokacionit në 544 m² (pesëqind e katër dhjetë e katër metër katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e organizatës HENDIKOS, po ashtu në këtë pjesë të pronës ekziston edhe objekt i palestrës sportive. Zh eshtorja e cila i 'u epët organizatës HANDIKOS për renovim dhe shfrytëzim.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 544 m² (pesëqind e katër dhjetë e katër metër katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e organizatës HENDIKOS, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij Vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e organizatës HANDIKOS dhe do të financohet nga vetë organizata HANDIKOS.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet, nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Komuna e Kaçanikut dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barrë tatimore, apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga organizata HANDIKOS.
7. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
8. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet HANDIKOS dhe mekanizma tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizmit,
Kadastrit dhe Mbrojtjes se Mjedisit
Nr. 06-944/01-15826/23
05.07.2023

NJOFTIM

Duke u bazuar në shkresën e Zn. Florije Kika, Drejtor i Depatamentit ligjor në Ministrinë e Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures, për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit, përkatësisht ligjshmërine e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.104/02-11896/23, të datës 30.05.2023, për caktimin e lokacionit për nevojat e Shoqatës Handikos, ju njoftojmë se:

Lokacioni i propozuar për shfrytëzim nga ana e Shoqatës Handikos, përkatësisht pjesët e parcelave kadastrale 228-0 dhe 229-0, Zona Kadastrale Bob, të cilat në shënimet e Zyres Kadastrale evidentohen si prone e Komunës së Kaçanikut, është paraparë si vendbanim.

Rrjedhimisht mendojmë se mund të lejohet lokacioni Shoqates Handikos, në parcelat e lartpërmendura.



Drejtori i Drejtorise
Qamir Stagova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



| | | | |
|----------|----------|---------|-----------------|
| Data | 16.06.23 | Vendi | KAÇANIK |
| Nj. org. | 01 | Numri | 104/02-11896/23 |
| | | Shtojcë | / |



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njesia org. 02
Org.lednica
Org.Unit
Nr. i Faqeve - 03
Br. Stranica
Na. Pages

Nr. i Prot. 3049-2/23
Broj Prot. Prot. No.
Date: 12.06.23
Date: No. 1

PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

| | |
|-------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Për: | Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor |
| Zyrtarët përgjegjës: | Nr. (V): 171/23 Datë: 07.06.2023 |
| 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të |
| 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit |
| Lloji i aktit: | Vendimi 01Nr.104/02-11896/23 për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS, miratuar nga KK Kaçanik. |

I nderuari Kryetar Ilazi,
I nderuari Kryesues Murseli,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 06.06.2023, ka pranuar nga MAPL Vendimin 01Nr.104/02-11896/23 për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS, miratuar nga KK Kaçanik, datë 30.05.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Kaçanikut:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi 01Nr.104/02-11896/23 për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS, miratuar nga KK Kaçanik, datë 30.05.2023.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 01Nr.104/02-11896/23 për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS, miratuar nga KK Kaçanik, konstatoi:

- Të shikohet lokacioni i planifikuar sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi;
- Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj;
- Nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor pjesën tekstuale dhe pjesën grafike në fuqi sipas Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Nëse në dokumente të planifikimit janë të përcaktuara shfrytëzimet dhe këto shfrytëzime janë komfor kërkesës, atëherë Kuvendi i Komunës nuk ka nevojë të nxjerrë vendim tjetër, sepse dokumentet e planifikimit hapësinor janë dokumente që miratohen nga ky Kuvend.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

